

Në bazë të nenit 16 të Ligjit për partitë politike të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 76/04, 5/07, 8/07, 5/08 dhe 23/13) dhe propozimin e Kuvendit themelues të ALEANCA PËR SHQIPTARËT, të miratuar në Kongresin e I më 10 mars të vitit 2018, plotësim ndryshimeve të miratuara në Kongresin e II më 27 mars të vitit 2022, plotësim ndryshimeve të miratuara në Kongresin e III të Jashtëzakonshëm, më 24 dhjetor të vitit 2022, si dhe plotësim ndryshimeve të miratuara në bazë të nenit 32 pika 1 e statutit në Kongresin e IV të Jashtëzakonshëm më 16 shkurt 2024 në Shkup u soll ky:

STATUT

DISPOZITAT THEMELORE

- Neni 1.** Ky statut është garanci e fuqishme se sovraniteti rrjedh nga baza partiake dhe i takon anëtarësisë së gjerë të ALEANCA PËR SHQIPTARËT.
- Neni 2.** Me këtë statut rregullohen:
1. Emri dhe shkurtesa e Partisë;
 2. Selia e Partisë;
 3. Simbolet e Partisë;
 4. Objektivat e veprimit politik;
 5. Transparenca në funksionim dhe mënyrën e të vepruarit;
 6. Kushtet dhe mënyra e anëtarësimit dhe ndërprerja e anëtarësimit, si dhe të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve;
 7. Përfaqësimi dhe prezantimi i Partisë politike;
 8. Organet e Partisë dhe dispozitat e funksionimit të saj;
 9. Përfitimi dhe menaxhimi me mjetet e Partisë;
 10. Ndërprerja e veprimit politik, si dhe posedimi i pasurisë në rast të shuarjes së Partisë.

EMRI DHE SHKURTESA E PARTISË

Neni 3. Emri i Partisë është "ALEANCA PËR SHQIPTARËT".

Neni 4. Shkurtesa e Partisë është ASH.

SELIA E PARTISË

Neni 5. Selia e ALEANCËS PËR SHQIPTARËT është në Tetovë, ndërsa zyra alternative e selisë është në Shkup.

SIMBOLET E PARTISË

- Neni 6.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT ka vulën në formë rrethi, vulën katrore, emblemën, flamurin dhe himnin e Partisë.
1. Vula në formë të rrethit përmban, në gjysmën e sipërme emrin ALEANCA PËR SHQIPTARËT – Tetovë, ndërsa në gjysmën e poshtme qëndron shkurtesa ASH dhe në mes emblema.
 2. Faksimilen e ka në formë të katërkëndëshit me tekstin: ALEANCA PËR SHQIPTARËT – Tetovë, me vendin e rezervuar për numrin e protokollit dhe datën.
 3. Teksti i vulës dhe faksimilja është e shkruar në gjuhën maqedone dhe shqipe.
 4. Emblema ka formën e drejtkëndëshit, ngjyra bazë e së cilës është vjollcë, me shqiponjën dykrerëshe si simbol me ngjyrë të verdhë në mes. Në pjesën e poshtme të simbolit të shqiponjës është teksti ALEANCA PËR SHQIPTARËT.
 5. Emblema e ALEANCËS PËR SHQIPTARËT duket si në Figurën 1.



Figura 1. Emblema Primare

6. Flamuri i ALEANCËS PËR SHQIPTARËT ka formën e drejtkëndëshit me proporcione 5:3. Ngjyra bazë e flamurit është vjollcë. Në mesin e flamurit gjendet emblema (Figura 2).



Figura 2. Proporcionet e Flamurit 5:3 (gjërësi - lartësi)

Neni 7. ALEANCA PËR SHQIPTARËT është parti politike që nëpërmjet formave demokratike dhe paqësore të veprimit synon sigurimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave kolektive të shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

TRANSPARENCA NË FUNKSIONIM DHE MËNYRËN E TË VEPRUARIT

Neni 8. ALEANCA PËR SHQIPTARËT synon krijimin dhe avancimin e mekanizmave të mirëfillta për një funksionim të drejtë, transparent dhe jodiskriminues të shtetit ligjor.

Neni 9. ALEANCA PËR SHQIPTARËT synon barazi të plotë etnike, kulturore dhe konfesionale, si pjesë e lirive dhe të drejtave elementare të njeriut dhe qytetarit.

Neni 10. ALEANCA PËR SHQIPTARËT angazhohet për aplikimin e mirëfilltë të parimeve të demokracisë konsensuale.

Neni 11. ALEANCA PËR SHQIPTARËT angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe hapje të vendeve të reja të punës nëpërmjet politikave adekuate ekonomike dhe nxitjes

së investimeve të drejtpërdrejta vendore dhe të huaja në sektorin real të ekonomisë së vendit.

- Neni 12.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT angazhohet për politika të drejta dhe transparente sociale dhe mbrojtje të të drejtave dhe dinjitetit të punëtorëve.
- Neni 13.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT angazhohet për politika të drejta arsimore dhe shëndetësore në vend.
- Neni 14.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT angazhohet për luftim të të gjitha formave të diskriminimit, qofshin ato në bazë etnike, fetare, moshe, gjuhësore, ekonomike, sociale etj.
- Neni 15.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT angazhohet për barazi gjinore dhe avancim të rinisë në strukturat e veta, andaj, në të gjitha organet vendimmarrëse të Partisë, gratë dhe rinia do të përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe adekuate deri në arritjen e barazisë së plotë.
- Neni 16.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT angazhohet për kultivim të zgjedhjeve transparente të drejta e të lira në përputhje me standardet më të larta demokratike.
- Neni 17.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT angazhohet për ndërtim dhe kultivim të marrëdhënieve të mira miqësore me shtetet fqinje dhe përshpejtim të procesit të integrimit të vendit në strukturat dhe organizatat ndërkombëtare.
- Neni 18.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT ofron një transparencë të plotë në funksionim dhe mënyrën e të vepruarit demokratik.
- Neni 19.* Objektivat dhe format e veprimit të ALEANCËS PËR SHQIPTARËT në të gjitha sferat e jetës shoqërore janë të përcaktuara me Platformën dhe Programin e ALEANCËS PËR SHQIPTARËT.

ORIENTIMI IDEOR I ALEANCËS PËR SHQIPTARËT

- Neni 20.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT është parti e qendrës së djathtë.
- Neni 21.* Koncepti bazë në ndërtimin e shtetit është koncepti liberal.
- Neni 22.* Në kuptimin e brendshëm organizativ ALEANCA PËR SHQIPTARËT ngërthen elemente të partive kadrovike dhe masovike.

INFORMIMI

- Neni 23.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT do të ndërtojë mekanizma gjegjësisht për informim të anëtarësisë së gjerë dhe opinionit për punën e saj, si një parakusht i domosdoshëm për parandalim të tendencave oligarkike dhe zhvillim të mirëfilltë të demokracisë brenda partiave.
- Neni 24.* Partia disponon faqen e saj elektronike (www.aleanca.eu).
1. Në faqen elektronike të Partisë shpallen të gjitha dokumentet relevante të Partisë, të dhënat biografike për pjesëtarët e forumeve të larta partiave, si dhe informata të tjera për punët dhe aktivitetet e Kryetarit të Partisë dhe organeve të saj.
 2. Në ueb faqen zyrtare të Partisë shpallet Statuti i Partisë, Programi i Partisë, Platforma e Partisë dhe dokumentet e tjera me rëndësi.
 3. Në faqen zyrtare të Partisë qëndron vegëza e veçantë, nëpërmjet së cilës anëtarët, simpatizantët dhe qytetarët e tjerë mund t'u drejtohen me pyetje dhe rekomandime Kryetarit të Partisë, kryetarit të Akademisë dhe anëtarëve të saj, Nënkrëtarëve të Partisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe anëtarëve të Kryesisë së Partisë.
 4. Në faqen zyrtare ekzistojnë nënseksione të Degëve të Partisë, ku qëndrojnë biografitë e detajuara të anëtarëve të kryesive të Degëve dhe Kryetarëve të Degëve.

ANËTARËSIMI

- Neni 25.* Anëtarë të Partisë janë të gjithë personat që plotësojnë kushtet ligjore për anëtarësim dhe i plotësojnë në mënyrë të rregullt obligimet statutare dhe programore.
- Neni 26.* Anëtarësia në ALEANCËN PËR SHQIPTARËT bëhet në bazë vullnetare.
- Neni 27.* ALEANCA PËR SHQIPTARËT mund të ketë edhe anëtarë nderi.
- Neni 28.* Statusin e Anëtarit të nderit e jep Kryesia e Partisë me propozim të Kryetarit të Partisë sipas një procedure të paraparë me rregullore të veçantë, me të cilën parashihen edhe parakushtet për marrjen e statusit të Anëtarit të nderit, si dhe të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të nderit.

MËNYRA E ANËTARËSIMIT

- Neni 29.* Kandidatët e interesuar për anëtarësim në ALEANCËN PËR SHQIPTARËT plotësojnë deklaratën e anëtarësimit.
- Neni 30.* Deklarata e anëtarësimit përmban këto të dhëna:
1. Emrin dhe mbiemrin,
 2. Adresën e vendbanimit,
 3. Kontaktet (telefonin fiks, celularin dhe adresat elektronike),
 4. Niveli arsimor i anëtarit,
 5. Shënimin që ai pranon të kontribuojnë për përcaktimet statutare dhe programore të Partisë dhe mban përgjegjësi për mosrespektimin eventual të të njëjtave.
- Neni 31.* Deklarata e aplikimit dorëzohet në Nëndegë ose në këshillin vendor, e cila në afat jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pune pas pranimit të aplikimit, ka për obligim që kandidatin zyrtarisht ta informojë për vendimin për pranim/refuzim të aplikimit.

Neni 32. Në rast të refuzimit eventual të aplikimit, aplikanti ka të drejtë që në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh të dorëzojë ankesë në Kryesinë e Degës përkatëse, vendimi i së cilës është përfundimtar.

E DREJTA E ANËTARËSIMIT

Neni 33. Të drejtë anëtarësimi në ALEANCËN PËR SHQIPTARËT kanë të gjithë qytetarët e moshës mbi 18 vjeç, të cilët:

1. I pranojnë përcaktimet statutare dhe programore të Partisë,
2. I pranojnë parimet bazë të veprimit politik demokratik,
3. Shprehin gatishmëri për të kontribuar në mënyrë të ndershme për realizimin e përcaktimeve statutare dhe programore të Partisë.

NDALESAT PËR ANËTARËSIM

Neni 34. Anëtarë të Partisë nuk mund të jenë personat:

1. Veprimet e të cilëve janë në kundërshtim me kodeksin etik të Partisë.
2. Persona për të cilët ka dëshmi materiale se merren me aktivitete kriminale dhe të ngjashme.
3. Persona që janë anëtarë aktiv të partive të tjera politike të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

NDËRPRERJA E ANËTARËSIMIT

Neni 35. Ndërprerja e anëtarësisë bëhet në mënyrë vullnetare ose si rezultat i largimit nga struktura partiake.

Neni 36. Në rast të çregjistrimit vullnetar, anëtari përkatës i Partisë dorëzon në Nëndegë deklaratë për ndërprerje të anëtarësisë në Parti.

Neni 37. Në rast të përjashtimit për shkak të mosrespektimit të obligimeve të anëtarit, nëndega zyrtarisht informon anëtarin për arsyet e përjashtimit.

- Neni 38.* Anëtar i përjashtuar në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh pas marrjes së vendimit për largim ka të drejtë të dorëzojë ankesë pranë Kryesisë së Partisë, vendimi i së cilës është përfundimtar.
- Neni 39.* Anëtarët e Partisë që bëhen anëtarë aktiv të partive të tjera të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut me automatizëm konsiderohen se e kanë ndërprerë anëtarësinë në ALEANCËN PËR SHQIPTARËT.
- Neni 40.* Në rast të mospagimit të anëtarësisë për periudhë dymbëdhjetë mujore pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm Partia rezervon të drejtën e ndërprerjes së anëtarësisë.

TË DREJTAT E ANËTARIT

- Neni 41.* Anëtarët e ALEANCËS PËR SHQIPTARËT i kanë të drejtat vijuese:
1. Të jenë të informuar për aktivitetet e organeve dhe trupave partiake,
 2. Të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur në organet dhe trupat partiake;
 3. Të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet publike të Kuvendit të Nëndegës, përkatësisht të Degës së Partisë;
 4. Të shprehin mendimet dhe qëndrimet e veta në mbledhjet e organeve partiake ku është anëtar;
 5. Të japin vërejtje për veprimin e organeve të Partisë dhe funksionarëve të zgjedhur të saj;
 6. Të dorëzojnë iniciativa pranë organeve partiake;
 7. Të kërkojnë përkrahjen e strukturave partiake në rast të cenimit të integritetit dhe dinjitetit personal dhe familjar si rezultat i veprimit politik.

OBLIGIMET E ANËTARIT

- Neni 42.* Anëtarët e ALEANCËS PËR SHQIPTARËT kanë obligimet vijuese:

1. Të marrin rregullisht pjesë në mbledhjet e organeve dhe trupave ku janë anëtarë,
2. Të paguajnë anëtarësinë,
3. T'u përmbahen dispozitave statutare dhe programore të Partisë,
4. Në takime partiake të sillen në pajtueshmëri me Kodeksin etik të Partisë.

PËRFAQËSIMI DHE PREZANTIMI I PARTISË POLITIKE

Neni 43. Partia në të gjitha takimet me partitë e tjera, organet shtetërore, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, përfaqësuesit e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të akredituara në Maqedoni përfaqësohet nga ana e Kryetarit të Partisë.

Neni 44. Partia në marrëdhëniet me publikun përfaqësohet edhe nga zëdhënësi i autorizuar nga ana e Kryetarit të Partisë.

ORGANET E PARTISË POLITIKE

Neni 45. Organet e ALEANCËS PËR SHQIPTARËT janë të klasifikuara në disa nivele:

1. Niveli i përgjithshëm:
 - a) Kongresi,
 - b) Kuvendi i Partisë,
 - c) Kryetari i Partisë,
 - d) Kryesia e Partisë,
 - e) Akademia,
 - f) Asambleja e Gruas,
 - g) Forumi Rinor,
 - h) Këshilli mbikëqyrës,
 - i) Komisioni statutar,
 - j) Komisioni i kuadrove të Partisë

2. Niveli i mesëm
 - a) Kuvendi i Degës,
 - b) Kryetari i Degës,
 - c) Kryesia e Degës,
 - d) Asambleja e Gruas e Degës,
 - e) Forumi Rinor i Degës,
 - f) Këshilli mbikëqyrës i Degës,
 - g) Komisioni i kuadrove të Degës.
 - h) Këshilli i Degëve të Shkupit i ASH-së
3. Niveli lokal
 - a) Kuvendi i Nëndegës,
 - b) Kryetari i Nëndegës
 - c) Kryesia e Nëndegës,
 - d) Këshilli Vendor
 - e) Këshilli i Vendvotimit

Neni 46. Strukturimi i organeve të ALEANCËS PËR SHQIPTARËT bëhet në bazë të organogramit të përpiluar në bazë të respektimit të parimeve vijuese:

1. Parimi i përfaqësimit të barabartë të regjioneve,
2. Parimi i moslejimit të diskriminimit në përfaqësim në organet partiake në bazë gjinore, moshe, sociale dhe formave të tjera,
3. Parimi i promovimit dhe avancimit të demokracisë brenda partiake, bazuar në Statutin e Aleancës për Shqiptarët si një nga veçoritë kyçe të ALEANCËS PËR SHQIPTARËT,
4. Parimi i respektimit të kriterëve të meritokracisë si një nga shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet funksionimi dhe veprimi i ALEANCËS PËR SHQIPTARËT,
5. Parimi i balancimit të autorizimeve midis niveleve dhe organeve të ndryshme me qëllim të kultivimit të drejtësisë, parandalimit të paraqitjes së oligarkëve partiakë dhe vendosjes së mekanizmave për të parandaluar çdo mundësi për keqpërdorim nga funksionarët e zgjedhur partiakë dhe shtetërorë.

KONGRESI

- Neni 47.* Organi më i lartë i Partisë është Kongresi.
1. Kongresi I ASH-së numëron nga 650 deri më 700 delegatë,
 2. Në këtë numër përfshihen edhe delegatët e diasporës,
 3. Delegatët e Kongresit propozohen nga ana e kuvendeve të Nëndegëve, ndërsa delegohen nga Kuvendi i Degës sipas kriterëve të parapara me rregulloren për konstituim dhe veprimin e Kongresit.
 4. Numri i delegatëve të Kongresit përcaktohet sipas numrit të votuesve shqiptarë që gravitojnë në Degët gjegjëse,
 5. Secila Nëndegë e ALEANCËS PËR SHQIPTARËT detyrimisht përfaqësohet me një delegat në Kongres,
 6. Në vendbanimet ku ALEANCA PËR SHQIPTARËT nuk ka Nëndegë, më tepër Këshilla VENDORË delegojnë një delegat në Kongres.
- Neni 48.* Kongresi mund të zhvillojë seanca të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
- Neni 49.* Kongresi mund të sjellë vendime të plotfuqishme nëse në mbledhje marrin pjesë më së paku 2/3 e delegatëve nga përbërja e tij.
- Neni 50.* Me punimet e Kongresit deri në momentin e zgjedhjes së Kryesisë së punës udhëheq Sekretari i Përgjithshëm.
- Neni 51.* Seancat e rregullta të Kongresit mbahen çdo katër vjet.
- Neni 52.* Seanca e rregullt e Kongresit thirret nga ana e Kuvendit të Partisë me autorizim të Kryetarit të Partisë, në afat jo më pak se tre muaj para ditës së mbajtjes.
- Neni 53.* Seancë e jashtëzakonshme obligative e Kongresit thirret në rastet në vijim:
1. Me kërkesë të Kryetarit të Partisë
 2. Me kërkesë të 2/3 të përbërjes së Kuvendit të Partisë.

KOMPETENCAT E KONGRESIT

- Neni 54.* Kongresi i Partisë ka kompetencat vijuese:
1. Miraton Statutin dhe ndryshimet e Statutit,
 2. Miraton programin dhe veprimet kryesore të Partisë,
 3. Përcakton vizionin për zhvillimin e Partisë,
 4. Miraton raportin e organeve dhe trupave të Partisë,
 5. Në përputhshmëri me rregulloren për punë të Kongresit zgjedh me votim të fshehtë anëtarët e Kuvendit të Partisë,
 6. Në përputhshmëri me rregulloren për punë të Kongresit zgjedh me votim të fshehtë Kryetarin e Partisë,
 7. Me shumicë 2/3 bën shkarkimin e Kryetarit të Partisë,
 8. Me propozim të Kuvendit të Partisë bën emërimin e Kryetarit të nderit të Partisë,
 9. Me shumicë 2/3 sjell vendim për shpërbërje të Partisë ose bashkimin e saj me ndonjë parti tjetër,
 10. Themelon këshillin e nderit të Partisë,
 11. Miraton Kodeksin Etik të Partisë,
 12. Sjell rregulloren për punën e Kongresit,
 13. Përcakton emrin dhe vendos për ndryshim të emrit të Partisë,
 14. Përcakton emblemen dhe vendos për ndryshim të emblems së Partisë,
 15. Përcakton himnin dhe vendos për ndryshimin e tij,
 16. Përcakton flamurin dhe vendos për ndryshimin e tij,
 17. Në përputhje me rregulloren për punë të Kongresit formon trupat punues të tij,
 18. Delegon kompetenca te trupat dhe organet e tjera të Partisë deri në mbledhjen e ardhshme të Kongresit,
 19. Sjell akte të tjera të përcaktuara me këtë Statut.

- Neni 55.* KONGRESI I PARTISË të gjitha vendimet i sjell me votat e shumicës të delegatëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve kur me këtë Statut është përcaktuar që vendimet të merren me 2/3-tat e votave të anëtarëve të Kongresit.

- Neni 56.* Mënyra e punës së Kongresit përcaktohet me rregulloren për punën e tij.

Neni 57. Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Kongresit në rrethana të jashtëzakonshme dhe emergjente i kryen Kuvendi i Partisë.

KUVENDI I PARTISË

Neni 58. Kuvendi i Partisë numëron nga 120 deri më 150 anëtarë.

Neni 59. Anëtar të Kuvendit të Partisë sipas statusit momental janë edhe kryetarët e Degëve.

Neni 60. Anëtarë të Kuvendit të Partisë, sipas statusit momental janë edhe të gjithë funksionarët e lartë shtetëror të Partisë: deputetët, ministrat, zv.ministrat, ambasadorët dhe kryetarët e komunave.

Neni 61. Anëtarë të Kuvendit të Partisë janë: kryetarja e Asamblesë së Gruas dhe kryetari i Forumit Rinor.

Neni 62. Kuvendi i Partisë takohet më së paku një herë në 6 muaj.

Neni 63. Kuvendi merr vendime fuqiplote nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se 1/2 e përbërjes së tij, me përjashtim të rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Statut.

Neni 64. Me mbledhjet e Kuvendit të Partisë kryeson Kryetari i Partisë.

Neni 65. Në rast pengese të Kryetarit të Partisë, me seancat e Kuvendit të Partisë udhëheq Sekretari i Përgjithshëm i Partisë.

Neni 66. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Partisë thirren sipas nevojës nga ana e Kryetarit të Partisë ose nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Partisë.

Neni 67. Sekretari organizativ ka obligim që në afat jo më vonë se shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të rregullt, anëtarët e Kuvendit të Partisë t'i pajisë me rendin e ditës dhe materialet e punës.

Neni 68. Kuvendi i Partisë në përputhje me rregulloren për punë të tij dhe përcaktimet statutare të Partisë zgjedh trupat për punë të Kuvendit.

KOMPETENCAT E KUVENDIT TË PARTISË

Neni 69. Kuvendi i Partisë ka kompetencat vijuese:

1. Me propozim të Kryetarit të Partisë zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë së Partisë,
2. Me propozim të Kryetarit të Partisë zgjedh kryetarin e Akademisë,
3. Miraton Platformën e Partisë,
4. Debaton për çështje aktuale politike, juridike dhe socio-ekonomike dhe merr qëndrim rreth tyre,
5. Përkujdeset për realizimin e përcaktimeve programore të Partisë,
6. Përcakton propozim-raport për punën e Partisë që do t'i dorëzohet Kongresit,
7. Miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Partisë,
8. Me propozim të Kryetarit të Partisë emëron komisionin për çështje financiare të Partisë,
9. Miraton listat e kandidatëve për deputet,
10. Miraton kandidaturat për kryetar komune,
11. Me propozim të Kryetarit të Partisë vendos për plotësimin e vendeve të zbrazura të Kuvendit të Partisë,
12. Me propozim të Kryetarit të Partisë sjell vendime për lidhje të bashkëpunimit me parti simotra jashtë vendit,
13. Sjell rregullore për funksionimin e vet,
14. Themelon komisione dhe trupa të tjerë punues,
15. Përcakton lartësinë e taksës së anëtarësisë, si dhe mënyrën e arkëtimit të saj,
16. Merr iniciativë për formimin e Asamblesë së Gruas,
17. Merr iniciativë për formimin e Forumit Rinor,
18. Kryen obligime të tjera të përcaktuara me këtë statut ose me autorizim të veçantë të Kongresit të Partisë.

KRYETARI I PARTISË

Neni 70. Kryetari i Partisë është lideri i Partisë.

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT TË PARTISË

Neni 71. Përveç dispozitave të përshkruara te përfaqësimi dhe prezantimi i Partisë politike, Kryetari i ka edhe të drejtat dhe përgjegjësitë vijuese:

1. Kryetari i Partisë formon kabinetin e tij në përbërje:
 - a). Shefi i kabinetit,
 - b). Përgjegjësi i protokollit,
 - c). Këshilltarë nga fusha të ndryshme,
 - d). Shofer
 - e). Personel për siguri dhe rend.
2. Propozon 30 anëtarë të Kuvendit të Partisë, duke respektuar parimet e nenit 46.
3. Thërret mbledhjet dhe udhëheq me punën e Kuvendit të partisë.
4. Thërret mbledhjet dhe udhëheq me punën e Kryesisë së partisë.
5. Emëron kryesuesin e Këshillit të Degëve të Shkupit.
6. Në rast të vërtetimit të shkeljeve statutare dhe programore nga ana e Degëve ose Nëndegëve, Kryetari i Partisë i propozon Kryesisë së Partisë suspendimin e tyre dhe në të njëjtën kohë i rekomandon Kuvendit të Partisë shpërndarjen dhe emërimin e përbërjes së përkohshme të re të tyre.
7. Kryetari i Partisë ka të drejtë që vendimet e organeve dhe trupave partiake që janë në kundërshtim me dispozitat statutare, programore dhe mënyrën demokratike të veprimit t'i nxjerrë për diskutim para Kuvendit të Partisë. Vendimi i Kuvendit të Partisë në këtë rast është përfundimtar.
8. Kryetari i Partisë i dorëzon raport Kongresit të Partisë për funksionimin e Partisë midis dy mbledhjeve të Kongresit.

ZGJEDHJA E KRYETARIT TË PARTISË

- Neni 72.* Kryetari i Partisë zgjidhet me mandat 4-vjeçar me të drejtë edhe për një rizgjedhje.
- Neni 73.* Kryetarin e Partisë e zgjedh Kongresi me propozim të komisionit kandidues.
- Neni 74.* Kandidatët për kryetar të Partisë e shpallin interesimin e tyre 2 muaj para mbajtjes së Kongresit, prej kur fillon edhe fushata parazgjedhore për kryetar partie.
- Neni 75.* Për të shpallur një anëtar i Partisë kandidaturën për kryetar partie, duhet të sigurojë minimum 400 nënshkrime të anëtarëve të verifikuar të Partisë, me kusht që mos i takojnë një dege të vetme, ose të sigurojë së paku mbështetjen e pesë Degëve të Partisë.
- Neni 76.* Kandidatët për kryetar partie, që i plotësojnë kushtet e parapara në nenin 74 dhe 75, kandidaturat e tyre, të mbështetura me dokumentacionin përkatës, i dorëzojnë deri te Komisioni qendror për mbajtjen e Kongresit, më së voni dy javë para mbajtjes së tij.
- Neni 77.* Kandidat i zgjedhur llogaritet ai që siguron më shumë se gjysmën e votave të delegatëve të pranishëm në Kongres.
- Neni 78.* Votimi është i fshehtë dhe çdo delegat ka në dispozicion vetëm një fletëvotimi.
- Neni 79.* Nëse delegati rrethon dy ose më shumë emra të kandidatëve garues, fletëvotimi shpallet i pavlefshëm.
- Neni 80.* Nëse asnjëri nga kandidatët e mundshëm nuk siguron shumicën e nevojshme, votimi përsëritet midis dy kandidatëve më të votuar.

Neni 81. Kryetar partie zgjidhet kandidati i cili merr shumicën e votave prej atyre që marrin pjesë në votim.

SHKARKIMI I KRYETARIT

Neni 82. Kryetarin e Partisë e shkarkon Kongresi me votat e 2/3-s së delegatëve të pranishëm në Kongres.

Neni 83. Iniciativë për ndërprerjen e mandatit të Kryetarit ndërmerr 2/3 e përbërjes së Kuvendit të Partisë.

Neni 84. Arsyeshmërinë juridike-statutare në lidhje me iniciativën për shkarkim e interpreton Komisioni Statutar.

Neni 85. Kryetari i Partisë shkarkohet në këto raste:

1. Shkelje e rëndë e Statutit dhe Platformës së Partisë,
2. Nëse dënohet me burgim për kryerjen e ndonjë vepre penale,
3. Në rast të dorëheqjes vullnetare,
4. Në rastet kur shëndeti i tij e pamundëson ta kryejë funksionin e Kryetarit.

Neni 86. Me punën e Kongresit ku vendoset për shkarkim të Kryetarit të Partisë, udhëheq Komisioni statutar.

Neni 87. Në të njëjtën seancë të Kongresit, zgjidhet Kryetari i ri i Partisë, sipas dispozitave të nenit 88 të Statutit.

Neni 88. Nëse Kongresi nuk e zgjedh Kryetarin e ri, ndërpritet puna e Kongresit dhe në afat prej 3-muajsh, përsëritet procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Partisë sipas nenit 82 të Statutit.

KRYESIA E PARTISË

Neni 89. Kryesia e Partisë është organi më i lartë ekzekutiv i Partisë.

Neni 90. Kryesia e Partisë është organ politik vendimmarrës.

- Neni 91.* Kryesia e Partisë numëron prej 21 deri 31 anëtarë, ku bëjnë pjesë edhe anëtarët nga diaspora.
- Neni 92.* Anëtarët e Kryesisë së Partisë zgjidhen nga ana e Kuvendit të Partisë me propozim të kryetarit të Partisë.
- Neni 93.* Në mbledhjet e Kryesisë së Partisë, sipas nevojës dhe pa të drejtë vote, marrin pjesë edhe deputetë, kryetarë komunash, funksionarë të caktuar shtetërorë, ministra, drejtorë të ndërmarrjeve publike, ambasadorë etj.
- Neni 94.* Në përbërjen e Kryesisë së Partisë, sipas Statutit, me të drejtë të plotë vote bëjnë pjesë me automatizëm:
1. Kryetari i Akademisë,
 2. Kryetarja e Asamblesë së Gruas.
 3. Kryetari i Forumit Rinor
- Neni 95.* Anëtarë të Kryesisë së Partisë nuk mund të jenë kryetarët e Degëve.
- Neni 96.* Kryesia e Partisë mban mbledhje sipas nevojës, por së paku 1 herë në dy muaj. Ajo sjell vendime të plotfuqishme nëse janë të pranishëm më së paku 1/2 e përbërjes së saj.
- Neni 97.* Mbledhjet e Kryesisë së Partisë i mbledh Kryetari i Partisë, i cili njëherit edhe i kryeson ato. Në rast të pamundësisë së Kryetarit, me mbledhjen e Kryesisë së Partisë mund të kryesojë edhe njëri nga Nënkryetarët me autorizim të veçantë të Kryetarit të Partisë.
- Neni 98.* Sekretari organizativ ka për obligim më së voni pesë ditë pune para mbajtjes së mbledhjes, përveç në raste të veçanta, anëtarët e Kryesisë së Partisë t'i pajisë me rendin e ditës dhe materialet e punës.

- Neni 99.** Vendimet e Kryesisë së Partisë sillen me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuara me dispozitat statutare.
- Neni 100.** Si raste të veçanta konsiderohen situatat e jashtëzakonshme në shtet, kur supozohet se një Degë e Partisë rëndë i ka shkelur parimet statutare, kur paraqitet nevojë e pashmangshme për përgjegjësi të ndonjë funksionari partiak dhe shtetëror etj.
- Neni 101.** Kryesia e Partisë, sipas nevojës, formon komisione dhe trupa punuese.
- Neni 102.** Pikë diskutimi në mbledhjet e Kryesisë së Partisë mund të propozojnë edhe:
1. Kryetari i Akademisë,
 2. Kryetarja e Asamblesë së Femrës,
 3. Kryetari i Forumit Rinor,
 4. Kryetari formal i fraksionit.
- Neni 103.** Sekretari i Përgjithshëm ka për obligim që Kryetarin e Partisë ta informojë për pikat e propozuara.
- Neni 104.** Mënyra e punës së Kryesisë së Partisë përcaktohet me Rregulloren e punës së Kryesisë së Partisë.

KOMPETENCAT E KRYESISË SË PARTISË

- Neni 105.** Kryesia e Partisë ka kompetencat në vijim:
- Neni 106.** Përkujdeset për implementim të vendimeve të marra nga Kuvendi i Partisë,
- Neni 107.** Debaton në lidhje me Platformën e Partisë,
- Neni 108.** Propozon ndryshime të Statutit të Partisë,
- Neni 109.** Propozon ndryshim të Programit të Partisë,

- Neni 110.* Kryesia e Partisë ia propozon Kuvendit të Partisë listën e kandidatëve të mundshëm për deputetë.
- Neni 111.* Kryesia e Partisë ia propozon Kuvendit të Partisë kandidatët e mundshëm për kryetar komune.
- Neni 112.* I ndërton dhe implementon qëndrimet politike të Partisë.
- Neni 113.* Bën emërim të bartësve të funksioneve shtetërore.
- Neni 114.* Mban llogari për respektim të dispozitave të Kodeksit etik të Partisë.
- Neni 115.* Vendos për çështje të tjera në përputhje me këtë Statut.
- Neni 116.* Kryen obligime të tjera të deleguara nga ana e Kuvendit të Partisë.

SHKARIMI I PARAKOHSHËM I ANËTARËVE TË KRYESISË

- Neni 117.* Anëtarët e Kryesisë së Partisë mund të shkarkohen edhe para skadimit të mandatit:
1. Nëse anëtari i Kryesisë së Partisë bie ndesh me Statutin, Platformën dhe politikat e Partisë,
 2. Nëse anëtari i Kryesisë së Partisë dënohet për kryerjen e ndonjë veprë penale,
 3. Nëse anëtari i Kryesisë së Partisë bie ndesh me Kodeksin etik të Partisë,
 4. Nëse anëtari i Kryesisë së Partisë për shkaqe shëndetësore nuk mund t'i kryejë obligimet partiake.
- Neni 118.* Komisioni statutar mund të japë vlerësim, bazuar në Statut, për shkarkim të anëtarit të Kryesisë së Partisë me kërkesë të këtij të fundit, në rastet kur behet fjalë për shkelje statutare dhe shkelje të Platformës.

Neni 119. Zgjedhja e anëtarit/ve të rinj të Kryesisë së Partisë bëhet sipas procedurave statutare në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Partisë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 120. Sekretarin e Përgjithshëm e zgjedh Kryesia e Partisë, me propozim të Kryetarit të Partisë, nëse për të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

Neni 121. Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm zgjat 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 122. Sekretari i Përgjithshëm kryen obligimet e parapara me këtë Statut dhe rregulloren për aktivitetet e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 123. Sekretarit i Përgjithshëm shkarkohet nga kjo pozitë nëse bën shkelje të Statutit dhe Platformës së Partisë, nëse vullnetarisht jep dorëheqje, nëse dënohet me burgim për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe nëse gjendja shëndetësore nuk i mundëson kryerjen e funksionit.

Neni 124. Sekretari i Përgjithshëm shkarkohet me propozim të Kryetarit të Partisë, nëse për shkarkimin e tij votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

Neni 125. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin e Partisë, si dhe për funksionimin e përditshëm të saj:

1. Merr pjesë në krijimin e politikave të Partisë;
2. Ndjek dhe përgjigjet për zbatimin e Statutit, vendimeve të miratuara nga Kongresi, si dhe rregulloreve e udhëzimeve të forumeve drejtuese të Partisë;
3. Pas çdo mbledhjeje të Kryesisë së Partisë, i mbledh kryetarët e Degëve për t'i informuar për vendimet e Kryesisë;
4. I ndihmon dhe i kontrollon organet drejtuese të strukturave vendore të Partisë për zbatimin e vendimeve të Kryesisë;

5. Mban evidencën e të dhënave të regjistrit të anëtarësisë së Partisë;
6. Kujdeset për mbarëvajtjen financiare të Partisë dhe
7. Udhëzon Sekretarin organizativ për realizimin e aktiviteteve.

SEKRETARI ORGANIZATIV

- Neni 126.* Sekretarin organizativ e zgjedh Kryesia e Partisë me propozim të Kryetarit të Partisë.
- Neni 127.* Mandati i Sekretarit organizativ zgjat 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje;
- Neni 128.* Mandatin e Sekretarit organizativ e ndërpret Kryetari i Partisë në raste të shkeljes së parimeve statutare, mosefikasitetit në kryerjen e detyrave dhe obligimeve ose kur i njëjti burgoset për kryerjen e ndonjë vepre penale.
- Neni 129.* Sekretari organizativ shkarkohet me propozim të Kryetarit të Partisë, nëse për shkarkimin e tij votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.
- Neni 130.* Sekretari organizativ:
1. Organizon mbledhjet e Kuvendit dhe Kryesisë së Partisë;
 2. I zbaton të gjitha vendimet që i merr nga Kryetari ose Kryesia e Partisë për çështjet organizative;
 3. Kujdeset për forcimin organizativ të Partisë;
 4. E mbikëqyr punën e Degëve të Partisë dhe raporton për to në mbledhjet e Kryesisë;
 5. Krijon grupe nismëtare që punojnë drejt themelimit të një njësie bazë të Partisë;
 6. Krijon grupe pune për ristrukturim;
 7. Krijon komunikim mes formave të ndryshme të organizuara në Parti;
 8. Raporton për punën e kryer te Kryetari i Partisë dhe në mbledhjet e Kryesisë.

NËNKRYETARI I PARTISË

- Neni 131.* Nënkyetarin e Partisë e zgjedh Kryesia e Partisë me propozim të Kryetarit të Partisë.
- Neni 132.* Numrin e nënkryetarëve e përcakton kryetari sipas nevojave konkrete në terren.
- Neni 133.* Mandati i Nënkyetarit ndërlidhet me mandatin e Kryetarit të Partisë.
- Neni 134.* Mandatin e Nënkyetarit e ndërpret Kryetari i Partisë në raste të shkeljes së parimeve statutare, mosefikasitetit në kryerjen e detyrave dhe obligimeve, kur Nënkyetari bie ndesh me Kodeksin etik të Partisë ose kur i njëjti burgoset për kryerjen e ndonjë vepre penale.
- Neni 135.* Nënkyetari i Partisë merr pjesë në krijimin e politikave të Partisë;
- Neni 136.* Kujdeset për promovimin e politikave të Partisë përpara grupeve të ndryshme të interesit në shoqëri;
- Neni 137.* E zëvendëson Kryetarin e Partisë, në mungesë të tij, me autorizim paraprak nga kryetari i Partisë;
- Neni 138.* Kryen edhe detyra të tjera, me autorizim nga Kryetari i Partisë.

GRUPI PARLAMENTAR

- Neni 139.* Grupin Parlamentar e përbëjnë përfaqësuesit e zgjedhur të ASH-së në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Neni 140.* Grupi Parlamentar:
- Implementon politikat e ASH-së në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
 - Shqyrton të gjitha çështjet parlamentare dhe inicion aktivitete ligjvënëse;

- Bashkërendon marrjen e vendimeve në harmoni me politikat e ASH-së, të adresuara nga Kryetari dhe Kryesia.

AKADEMIA

- Neni 141.* Akademia është organ strategjik-këshillëdhënës i Partisë.
- Neni 142.* Në mbledhjet e Akademisë me të drejta të plota marrin pjesë Kryetari i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm, kryetarja e Asamblesë së Gruas dhe kryetari i Forumit Rinor.
- Neni 143.* Anëtarët e Akademisë i propozon Kryetari i Partisë, në bashkëpunim me kryetarin e Akademisë.
- Neni 144.* Mandati i kryetarit të Akademisë zgjat katër vjet, me të drejtë edhe për një rizgjedhje.
- Neni 145.* Për kryetar Akademie mund të zgjidhet personi që është dëshmuar me veprimtarinë e tij teorike-shkencore dhe praktike.
- Neni 146.* Kryetari i Akademisë zgjidhet nëse për të votojnë më shumë se gjysma e kuvendarëve të pranishëm.
- Neni 147.* Mandati i kryetarit të Akademisë ndërpritet edhe para kohe nëse puna e tij bie ndesh me Statutin dhe Platformën e Partisë, kur bie ndesh me Kodeksin e Partisë, nëse dënohet për kryerjen e ndonjë vepre penale, ose kur gjendja shëndetësore nuk i mundëson ta kryejë funksionin e besuar.
- Neni 148.* Propozimin për shkarkim të kryetarit të Akademisë e bëjnë Kryetari i Partisë ose 2/3 e anëtareve të Akademisë.
- Neni 149.* Kryetarin e Akademisë e shkarkon Kuvendi i Partisë nëse për shkarkim votojnë më shumë se gjysma e kuvendarëve të pranishëm.

- Neni 150.* Mandati i anëtarëve të Akademisë është i pakufizuar dhe zgjat përderisa Kryetari i Partisë dhe kryetari i Akademisë konstatojnë se i njëjti nuk është në gjendje të ofrojë atë që Partia pret nga ai.
- Neni 151.* Anëtarëve të Akademisë u ndërpritet mandati edhe në rastet kur mungojnë në mbledhje 3 herë me radhë pa ndonjë arsyetim.
- Neni 152.* Anëtar i Akademisë me automatizëm bëhet çdo kryetar dhe sekretar i përgjithshëm i Partisë, të cilit i skadon mandati.
- Neni 153.* Anëtarët e Akademisë nga radhët e veta e zgjedhin nënkryetarin e Akademisë.
- Neni 154.* Anëtarët e Akademisë detyrimisht duhet të jenë anëtarë të Aleancës për Shqiptarët. Përrjashtimet mund të ndodhin nëse për anëtar akademie zgjidhet një person jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Neni 155.* Mbledhjet e Akademisë zhvillohen sipas nevojës, por së paku 1 herë në dy muaj me iniciativë të kryetarit të Akademisë ose Kryetarit të Partisë.
- Neni 156.* Aktivitet parësor i Akademisë është ndërtimi i politikave strategjike për veprim të Partisë në të gjitha nivelet. Ajo i përgatit të gjitha aktet normative, duke filluar prej Statutit, Platformës, Strategjisë afatshkurte, afatmesme, afatgjate etj.
- Neni 157.* Akademia formon komisione profesionale punuese, në të cilat marrin pjesë edhe ekspertë të dalluar që janë të përfshirë në Kryesinë e Partisë.
- Neni 158.* Akademia ka për obligim t'i ndihmojë profesionalisht, në të gjitha aspektet, bartësit e funksioneve nga radhët e Aleancës për Shqiptarët.

QENDRA ANALITIKE

- Neni 159.* Në kuadër të Partisë funksionon Qendra analitike e Aleancës për Shqiptarët.
- Neni 160.* Qendra analitike është njësi kërkimore, e cila përpilon raporte, analiza dhe propozon masa për përmirësimin e politikave të Partisë;
- Neni 161.* Analizon të dhënat e rezultateve të dala nga zgjedhjet, duke i krahasuar me rezultatet paraprake.
- Neni 162.* Qendra analitike organizon sondazhe për nevojat e Partisë.
- Neni 163.* Qendra analitike bën vlerësimin e politikave publike, monitoron zhvillimin e proceseve politike dhe zgjedhore.
- Neni 164.* Qendra analitike sistematizon të dhënat nga sondazhet politike, përpunon të dhënat e karakterit politik, ekonomik, social, ndëretnik, ndërkulturor, konfesional, të sigurisë etj.
- Neni 165.* Qendra analitike rezultatet nga analizat e bëra, raportet dhe vlerësimet, i dërgon deri te Kryesia e Partisë.
- Neni 166.* Qendra analitike, për një efikasitet sa më të lartë, zhvillon bashkëpunim edhe me ekspertë të dalluar jashtë radhëve partiake dhe jashtë RMV-së.

ASAMBLEJA E GRUAS

- Neni 167.* Kryetarja e Asamblesë së Gruas zgjidhet me mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 168. Kryetarja e Asamblesë së Gruas paraqet raport për aktivitetet e realizuara dhe të planifikuara çdo 6 muaj përpara Kuvendit të Partisë.

Neni 169. Organizimi, funksionimi, si dhe mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të bartësve të funksioneve të Asamblesë së Gruas rregullohen me rregullore të veçantë, të bazuar në parimet themelore të Statutit.

FORUMI RINOR

Neni 170. Mandati i kryetarit të Forumit Rinor zgjat 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 171. Kryetari i Forumit Rinor paraqet raport për aktivitetet e realizuara dhe të planifikuara çdo 6 muaj përpara Kuvendit të Partisë.

Neni 172. Organizimi, funksionimi, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të bartësve të funksioneve të Forumit Rinor rregullohen me rregullore të veçantë, të bazuar në parimet e Statutit.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 173. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë anëtarë të Kuvendit të Partisë, ndërsa nuk janë te përfaqësuar në Kryesinë e Partisë.

Neni 174. Këshilli mbikëqyrës mbikëqyr punën administrative të Kryesisë së Partisë. Për punën administrative dhe punët financiare i jep raport Kuvendit të Partisë 1 herë në vit.

KOMISIONI STATUTAR

- Neni 175.* Komisionin statutar e zgjedh Kuvendi i Partisë me shumicën e votave të kuvendarëve të pranishëm.
- Neni 176.* Komisioni statutar përbëhet nga kryetari i komisionit dhe 4 anëtarë të komisionit të propozuar nga Kryetari i Partisë, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm.
- Neni 177.* Komisioni statutar ndjek zgjedhjet brendapartiake në të gjitha nivelet.
- Neni 178.* Komisioni statutar intervenon nëse ka shkelje statutare.
- Neni 179.* Komisioni statutar ka për detyrë t'i interpretojë dispozitat e Statutit. Në rast nevojë angazhohen ekspertë të fushës nga jashtë.

SHKARKIMI I PARAKOHSHËM

- Neni 180.* Anëtari i Komisionit statutar mund të shkarkohet nëse:
1. Burgoset për shkak të kryerjes të ndonjë vepre penale,
 2. Bie ndesh me Kodin etik të Partisë,
 3. Ka probleme shëndetësore që pengojnë kryerjen e obligimeve.
- Neni 181.* Propozimin për shkarkim të anëtarit të Komisionit statutar e jep Kryetari i Partisë në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm.
- Neni 182.* Anëtarët e Komisionit statutar shkarkohen nëse për shkarkimin e tyre votojnë më shumë se gjysma e kuvendarëve të pranishëm.

KOMISIONI I KUADROVE TË PARTISË

- Neni 183.* Komisioni i kuadrove të Partisë, përbëhet nga Kryetari i Partisë, Nënkryetari i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm, kryetarja e Asamblesë së Gruas dhe kryetari i Forumit Rinor.

- Neni 184.** Në mbledhjet e komisionit të kuadrove të Partisë merr pjesë edhe Kryetari i Degës gjegjëse kur bëhet fjalë për propozimin e ndonjë funksionari në ekzekutiv që graviton nga dega e tij.
- Neni 185.** Komisioni i kuadrove të Partisë vendimet i sjell me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm.
- Neni 186.** Funksionarët e emëruar çdo 6 muaj dërgojnë raport me shkrim deri te Komisioni i kuadrove të Partisë për aktivitetet e tyre në drejtim të zbatimit të Platformës së Partisë.
- Neni 187.** Komisioni i kuadrove të Partisë pas analizës së detajuar i propozon Kryesisë së Partisë vazhdimin, gjegjësisht ndërprerjen e mandatit të mëtutjeshëm të funksionarëve të emëruar nga Aleanca për Shqiptarët.

DEGA

- Neni 188.** Dega e Partisë përfshin të gjithë anëtarët e Partisë që kanë rezidencë në territorin e një komune.
- Neni 189.** Territori i Degës përcaktohet sipas ndarjes territoriale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Neni 190.** Dega e Partisë ka organet në vijim:
1. Kuvendi i Degës
 2. Kryetari i Degës
 3. Kryesia e Degës
 4. Sekretari i Degës
 5. Këshilli mbikëqyrës
 6. Komisioni i kuadrit të Degës.

KUVENDI I DEGËS

- Neni 191.** Madhësia e Kuvendit të Degës përcaktohet në varësi nga numri i votuesve shqiptarë që jeton në suaza të Degës.

- Neni 192.* Anëtarët e Kuvendit të Degës delegohen nga ana e Kuvendeve të Nëndegëve sipas rregullores të sjellë nga Kuvendi i Partisë.
- Neni 193.* Anëtarë të Kuvendit të Degës me automatizëm janë edhe anëtarët e Partisë që janë zgjedhur këshilltarë komunalë.
- Neni 194.* Anëtarët e Kuvendit të Degës zgjidhen me mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
- Neni 195.* Me punën e Kuvendit të Degës deri në zgjedhjen e kryesisë së punës udhëheq kuvendari më i moshuar.
- Neni 196.* Kuvendi i Degës mban mbledhje më së paku 1 herë në 6 muaj.
- Neni 197.* Mbledhjet e Kuvendit të Degës thirren nga ana e Kryetarit të Degës me vendim të Kryesisë së Degës.
- Neni 198.* Kuvendi i Degës sjell vendime fuqiplote nëse në mbledhje marrin pjesë më së paku 1/2 e përbërjes së kuvendit.
- Neni 199.* Kuvendarët pajisen me rendin e ditës dhe materialet e punës jo më vonë se tri ditë pune para datës së mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të Degës.

KOMPETENCAT E KUVENDIT TË DEGËS

- Neni 200.* Kuvendi i Degës i ka kompetencat vijuese:
1. Miraton raportin e Kryesisë së Degës dhe Kryetarit të Degës,
 2. Miraton listën përfundimtare të kandidatëve të mundshëm për këshilltarë komunalë,
 3. Propozon listën e kandidatëve për kryetar komune,
 4. Propozon listën e kandidatëve të mundshëm për deputetë,
 5. Debaton dhe merr qëndrime rreth çështjeve që kanë të bëjnë me Degën.
- Neni 201.* Kuvendi i Degës e zgjedh Kryetarin e Degës dhe Kryesinë e Degës.

Neni 202. Kryen të gjitha kompetencat e tjera të parapara me këtë Statut.

KRYETARI I DEGËS

Neni 203. Mandati i Kryetarit të Degës zgjat katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

ZGJEDHJA E KRYETARIT TË DEGËS

Neni 204. Kryetari i Degës zgjidhet përmes Thirrjes publike, me vendim të kryesisë së partisë.

Neni 205. Kandidati për kryetar dege duhet të jetë anëtar partie.

Neni 206. Kandidati për kryetar dege paraqet biografinë dhe programin e tij.

Neni 207. Pas dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar, secili kandidat do të intervistohet nga komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve.

Neni 208. Çdo kandidat i paraqitur do të trajtohet në mënyrë të barabartë në zgjedhje.

Neni 209. Kandidatët do të zgjidhen në bazë të aftësive individuale, sukseseve nga e kaluara dhe vizioni për të ardhmen.

Neni 210. Aleanca për Shqiptarët mban të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura në biografitë e kandidatëve.

Neni 211. Afati i paraqitjes së kandidaturave është 7 ditë nga dita e shpalljes.

Neni 212. Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për Kryetar Dege përbëhet nga 3 anëtarë:

1. Kryetari i Partisë;
2. Sekretari i Përgjithshëm dhe

3. Sekretari Organizativ.

- Neni 213.* Kandidati i përzgjedhur i paraqitet Kuvendit të Degës.
- Neni 214.* Kuvendi i degës me vota të fshehta zgjedh Kryetarin e Degës.
- Neni 215.* Në rast të mos zgjedhjes së kandidatit të përzgjedhur nga komisioni, Kuvendi i Degës merr të drejtën e propozimit të kandidatëve dhe zgjedhjes së Kryetarit të Degës me votim të fshehtë.

KOMPETENCAT E KRYETARIT TË DEGËS

- Neni 216.* Kryetari i Degës i ka të drejtat vijuese:
1. Në rast të vërtetimit të shkeljeve statutare dhe programore nga ana e Nëndegëve, i rekomandon Kuvendit të Degës të bëjë shpërndarjen e Nëndegës dhe emërimin e përbërjes së përkohshme deri në formimin e Nëndegës së re.
 2. Kryetari i Degës i dorëzon raport Kuvendit të Degës për funksionimin e Degës midis dy mbledhjeve të Kuvendit të Degës.
 3. Kryetari i Degës e emëron dhe e shkarkon Nënkryetarin Degës.
 4. Kryetari i Degës i propozon Kuvendit të Degës të zgjedhë Sekretarin e Degës.
- Neni 217.* Kryetari i Degës menaxhon punët ditore të Degës në përputhje me rregulloren për punë të Degës dhe organeve të saj.
- Neni 218.* Iniciativë për ndërprerjen e mandatit të Kryetarit të Degës merr Kryetari i Partisë, ose 2/3 e përbërjes së Kuvendit të Degës.

MËNYRA E SHKARKIMIT TË KRYETARIT TË DEGËS

- Neni 219.* Kryetari i Degës mund të shkarkohet nga Kuvendi i Degës nëse për shkarkim votojnë më shumë se gjysma e kuvendarëve të pranishëm, edhe atë:

1. Kur bën shkelje të rëndë të Statutit dhe Platformës së Partisë,
2. Kur bën shkelje të rëndë të Kodeksit etik të Partisë,
3. Kur dënohet me burgim për ndonjë vepër penale,
4. Kur për arsye shëndetësore nuk është në gjendje të ushtrojë postin e Kryetarit.

Neni 220. Vlerësim për iniciativën e shkarkimit jep Komisioni statutar, i cili në të njëjtën kohë edhe udhëheq me mbledhjen e Kuvendit të Degës, ku vendoset për shkarkimin e Kryetarit të Degës.

Neni 221. Në mbledhjen e njëjtë zgjidhet Kryetari i ri i Degës sipas nenit 198 të Statutit. Nëse nuk zgjidhet Kryetari i Degës, Kuvendi i ndërpret aktivitetet dhe zgjedhja e Kryetarit të ri bëhet pas 3 muajsh në bazë të nenit 196 të Statutit.

Neni 222. Deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, me Degën udhëheq Sekretari i Degës.

KRYESIA E DEGËS

Neni 223. Kryesia e Degës është organi më i lartë në nivel të Degës midis dy Kuvendeve të Degës.

Neni 224. Anëtarët e Kryesisë së Degës i zgjedh Kuvendi i Degës.

Neni 225. Të zgjedhur llogariten kandidatët e propozuar për të cilët kanë votuar më shumë se gjysma e kuvendarëve të pranishëm.

Neni 226. Nëse ndonjëri nga kandidatët e propozuar nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave, nëndega gjegjëse propozon kandidat tjetër, i cili i nënshtrohet po të njëjtës procedurë zgjedhore.

Neni 227. Kryesia e Degës numëron maksimum 31 anëtarë.

Neni 228. Në mbledhjet e Kryesisë së Degës pa të drejtë të votës, për shkak të vazhdimësisë, marrin pjesë edhe anëtarët e Kryesisë dhe të Kuvendit të Partisë nga po e njëjta Degë.

- Neni 229.* Në mbledhjet e Kryesisë së Degës marrin pjesë pa të drejtë vote edhe anëtarë të tjerë të autorizuar nga Kryesia e Partisë dhe anëtarët e Partisë të zgjedhur këshilltarë komunalë.
- Neni 230.* Kryesia e Degës mban mbledhje sipas nevojës, por së paku 1 herë në dy muaj.
- Neni 231.* Mbledhjet e Kryesisë së Degës i konvokon Kryetari i Degës i cili njëherit edhe i kryeson ato. Në rast të pamundësisë së Kryetarit të Degës, me mbledhjen e Kryesisë së Degës mund të kryesojë Nënkryetari i Degës, Sekretari i Degës ose ndonjë anëtar i Kryesisë së Degës me autorizim të veçantë të Kryetarit të Degës.
- Neni 232.* Në mbledhjen e Kryesisë së Degës, sipas nevojës, marrin pjesë edhe kryetarët e Nëndegës.
- Neni 233.* Vendimet e Kryesisë së Degës sillen me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuar me dispozitat statutare.
- Neni 234.* Kryesia e Degës sipas nevojës formon komisione dhe trupa punuese.
- Neni 235.* Mënyra e punës së Kryesisë së Degës përcaktohet me Rregulloren për punë të Kryesisë së Degës.

KOMPETENCAT E KRYESISË SË DEGËS

- Neni 236.* Kryesia e Degës ka kompetencat vijuese:
1. Përkujdeset për implementim të vendimeve të marra nga Kuvendi i Degës,
 2. Kryesia e Degës ia propozon Kuvendit të Degës listën e kandidatëve të mundshëm për funksionet lokale dhe të përgjithshme.
 3. Ndërton dhe implementon qëndrimet politike të Partisë në nivel të Degës,

4. Formon komisione në nivel të Degës,
5. Kryen obligime të tjera të deleguara nga ana e Kuvendit të Degës.

SEKRETARI I DEGËS

- Neni 237.* Sekretari i Degës zgjidhet me mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
- Neni 238.* Sekretarin e Degës e zgjedh Kuvendi i Degës. I zgjedhur llogaritet kandidati i cili ka fituar më shumë se gjysmën e votave të kuvendarëve të pranishëm.
- Neni 239.* Sekretari i Degës i kryen obligimet e parapara me këtë Statut dhe aktet e tjera normative të Partisë.
- Neni 240.* Sekretari i Degës menaxhon dhe koordinon administratën e Degës.
- Neni 241.* Sekretari i Degës ka për obligim që më së voni tre ditë pune para mbajtjes së mbledhjes, përveç në rastet e veçanta, t'i pajisë anëtarët e Kryesisë së Degës me rendin e ditës dhe materialet e punës.

SHKARKIMI I ANËTARËVE TË KRYESISË SË DEGËS

- Neni 242.* Anëtar i Kryesisë së Degës mund të shkarkohet nga ana e Kuvendit të Degës para përfundimit të mandatit nëse për këtë shkarkim votojnë më shumë se gjysma e kuvendarëve të pranishëm.
- Neni 243.* Anëtarët e Kryesisë së Degës shkarkohen kur:
1. Bëjnë shkelje të rëndë të Statutit dhe Platformës të Partisë,
 2. Bëjnë shkelje të rëndë të Kodeksit etik të Partisë,
 3. Burgosen për shkak të kryerjes së ndonjë vepre penale,
 4. Për arsye shëndetësore nuk janë në gjendje të ushtrojnë postin e anëtarit të kryesisë.

- Neni 244.* Vlerësim për iniciativën e shkarkimit jep Komisioni statutar.
- Neni 245.* Deri në zgjedhjen e anëtarit të ri të Kryesisë së Degës atë e zëvendëson Kryetari i Nëndegës ose personi i autorizuar nga ai.
- Neni 246.* Anëtari/ët e Kryesisë së Degës zgjidhen në Kuvendin e radhës të Degës sipas procedurës së paraparë me Statut.

KËSHILLI MBIKQYRËS

- Neni 247.* Këshilli mbikëqyrës i Degës përbehet nga 5 anëtarë, të cilët janë anëtarë të Kuvendit të Degës, ndërsa nuk janë te përfaqësuar në Kryesinë e Degës.

KOMISIONI I KUADROVE TË DEGËS

- Neni 248.* Në nivel të Degës formohet Komisioni i kuadrove të Degës.
- Neni 249.* Në Komisionin e kuadrove të Degës marrin pjesë: Kryetari i Degës, Sekretari, Nënkryetarët e Degës, kryetarja e Asamblesë, kryetari i Forumit Rinor, një anëtar i deleguar nga Komisioni i kuadrove të Partisë dhe sipas nevojës Kryetari i Nëndegës nga e cila propozohet kandidati.
- Neni 250.* Komisioni i kuadrove të Degës propozimet i përcjell deri te Kryesia e Degës, e cila zyrtarisht e njofton Kryetarin e Partisë që të ndër marrë aktivitete të mëtutjeshme të bazuara në kompetencat e tij ligjore.
- Neni 251.* Nëse në suaza të komisionit të kuadrove të Degës ka divergjencë të patejkalueshme për ndonjë rast të caktuar, kompetencat kalojnë në Komisionin e kuadrove të Partisë.

KËSHILLI I DEGËVE TË SHKUPIT

- Neni 252.* Në Këshillin e Degëve të Shkupit, përfshihen të gjitha degët e Partisë që bëjnë pjesë në kuadër të qytetit të Shkupit.

Neni 253. Këshilli i Degëve të Shkupit është organ koordinues i aktiviteteve të Degëve të Shkupit të ASH-së.

Neni 254. Këshilli i Degëve të Shkupit mbledhet sa herë që paraqitet nevoja, nën drejtimin e Kryesuesit të Këshillit të Degëve, i emëruar nga Kryetari i Partisë.

Neni 255. Kompetencat e Këshillit të Degëve të Shkupit janë:

1. Diskuton për çështjet që lidhen me probleme të qeverisjes lokale në nivel qyteti;
2. Propozon e merr veprime për përsosjen e organizimit e të veprimit elektoral në nivel të qytetit të Shkupit, gjatë zgjedhjeve lokale;
3. Propozon përfaqësuesit e saj të zgjedhur në qeverisjen vendore në nivel të qytetit;
4. Koordinon aktivitetin e këshilltarëve të ASH-së në Këshillin e qytetit të Shkupit.

Neni 256. Anëtarët e Këshillit të Degëve të Shkupit janë:

1. Anëtarët e Kryesisë së Partisë, përfaqësues nga Degët e Shkupit;
2. Kryetarët e Degëve të Partisë në kuadër të qytetit të Shkupit;
3. Deputetët që kanë bazën e tyre në njërin nga Degët e Shkupit;
4. Kryetarët e komunave të Shkupit (anëtarë partie);
5. Këshilltarët e Kuvendit të qytetit të Shkupit;
6. Përfaqësuesit e emëruar në institucionet dhe ndërmarrjet në kuadër të qytetit të Shkupit;
7. Një përfaqësues nga Asambleja e Gruas dhe Forumi Rinor.

NËNDEGA

Neni 257. Nëndega e përfshin anëtarësinë e një regjioni të caktuar gjeografik.

Neni 258. Nëndega numëron minimum 21 anëtarë.

Neni 259. Partia ka Nëndegë në fshatra dhe Nëndegë në qytet.

- Neni 260.* Nëndega e fshatit përfshin tërë territorin gjeografik të fshatit.
- Neni 261.* Territori i Nëndegëve në qytet, përcaktohet sipas ndarjes territoriale të qytetit.
- Neni 262.* Organet e Nëndegës janë:
1. Kuvendi i Nëndegës,
 2. Kryetari i Nëndegës dhe
 3. Kryesia e Nëndegës

KUVENDI I NËNDEGËS

- Neni 263.* Kuvendi i Nëndegës përbëhet nga të gjithë anëtarët e Nëndegës.
- Neni 264.* Kuvendi i Nëndegës ka autorizimet në vijim:
1. Propozon anëtarë të Kuvendit të Degës,
 2. Propozon kandidatë të mundshëm për këshilltarë komunalë,
 3. Propozon kandidat të mundshëm për kryetar komune,
 4. Propozon kandidatë të mundshëm për deputetë.
- Neni 265.* Kuvendi i Nëndegës emëron:
1. Kryesinë e Nëndegës dhe
 2. Kryetarin e Nëndegës.

KRYETARI I NËNDEGËS

- Neni 266.* Kryetari i Nëndegës udhëheq me organet e Nëndegës dhe komunikon me organet e Degës së Partisë.

KRYESIA E NËNDEGËS

- Neni 267.* Kryesia e Nëndegës është organi më i lartë i Nëndegës midis dy takimeve të Kuvendit të Nëndegës.

KËSHILLI VENDOR

- Neni 268.* Këshilli vendor është njësia më e vogël organizative e ASH-së.
- Neni 269.* Këshilli vendor organizohet si në fshatra ashtu edhe në qytete.
- Neni 270.* Këshillin vendor e formojnë minimum 5 anëtarë të ASH-së.
- Neni 271.* Këshilli vendor zgjedh kryetarin e vet.
- Neni 272.* Disa këshilla vendorë (që arrijnë numrin 21 anëtarë) i posedojnë të drejtat dhe obligimet e një nëndege.

KËSHILLI I VENDVOTIMIT

- Neni 273.* Këshilli i vendvotimit
1. Këshilli i vendvotimit është njësia bazë e Partisë;
 2. Këshilli i vendvotimit përbëhet më së paku prej 3 anëtarësh;
 3. Këshilli i vendvotimit duhet të pasqyrojë barazinë gjinore dhe rininë;
 4. Anëtarët e këshillit të vendvotimit gjatë proceseve zgjedhore janë anëtarë komisioni zgjedhor ose vëzhgues në vendvotimin ku jetojnë dhe veprojnë.

PËRFITIMI DHE MENAXHIMI ME MJETET E PARTISË

- Neni 274.* Me qëllim të realizimit të synimeve të Partisë, Partia fiton dhe disponon me mjete dhe të drejta mbi mjetet në përputhje me rregullativën më të gjerë juridike, me ligjin për financim të partive politike, si dhe me Statut.
- Neni 275.* Partia realizon mjetet financiare, sende dhe të mira materiale, të cilat mund të burojnë nga burime publike dhe burime private.

- Neni 276.* Burimet publike janë mjete financiare të parapara me buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me Ligjin për financim të partive politike.
- Neni 277.* Burime private të financimit të Partisë politike janë burimet nga anëtarësia, dhuratat, legatët, sponsorimet, dotacionet dhe burimet e tjera në përputhje me Ligjin për financim të partive politike.
- Neni 278.* Mjetet, të drejtat e sipërpërmendura, mund të shfrytëzohen në përputhje me planet financiare të përcaktuara dhe miratuara me dokumente përkatëse.
- Neni 279.* Kryetari i Partisë është realizues dhe urdhërues për realizim të planit financiar në sajë të të drejtave dhe obligimeve të përcaktuara me ligj dhe Statut, ndërsa atë e zëvendëson Nënkryetari i autorizuar në rastet kur lind nevoja për një gjë të tillë.
- Neni 280.* Partia mban evidencë financiare-kontabël lidhur me punën e vet materiale-financiare, e cila mbahet në përputhje me dispozitat e Ligjit për kontabilitet për organizatat jofitimprurëse.
- Neni 281.* Në rastet e shuarjes së Partisë nga cilatdo shkaqe ligjore ose shkaqe të përcaktuara me këtë Statut, pas përmbushjes së obligimeve të Partisë, mjetet e mbetura kalojnë në pronësi të Muzeut të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir.

DISPOZITAT E VEÇANTA

FRAKSIONET PARTIAKE

- Neni 282.* Aleanca për Shqiptarët, për shkak të ndërtimit të një niveli sa më të lartë të demokracisë së brendshme, mundëson veprimin e fraksioneve partiake brenda saj.

- Neni 283.* Aktiviteti i fraksioneve partiake nuk guxon të jetë në kundërshtim me idetë themelore të Partisë.
- Neni 284.* Fraksionet partiake lirshëm mund të veprojnë edhe për arritjen e qëllimeve që janë në kundërshtim me politikat aktuale të organeve më të larta të Partisë me qëllim të avancimit të demokracisë së brendshme dhe homogjenizimit sa me të lartë të Aleancës për Shqiptarët.
- Neni 285.* Fraksionet partiake mund të formohen në baza gjinore, grupmoshave, në baza profesionale, rajonale etj.
- Neni 286.* Fraksionin e përbëjnë më së paku 20% e anëtarëve të Kuvendit të Partisë.
- Neni 287.* Një anëtar i Kuvendit të Partisë nuk mund të jetë pjesë e më tepër se një fraksioni.
- Neni 288.* Fraksionet i shprehin bindjet e veta përmes liderit formal të tyre.
- Neni 289.* Aspektin statutar-juridik të krijimit të kushteve për formim të një fraksioni partiak e vlerëson Komisioni statutar.
- Neni 290.* Komisioni statutar e ndjek në vazhdimësi aktivitetin e fraksioneve brendapartiake dhe ndërpret aktivitetin e tyre në raste kur fraksioni partiak e dëmton bindshëm idenë bazë të Partisë në përgjithësi.

SHKOLLA E KUADROVE

- Neni 291.* Për hir të ndërtimit të një politike sa më të qëndrueshme dhe kompetente, Partia duhet të krijojë kushte për veprimin e shkollës së kuadrove.
- Neni 292.* Shkolla e kuadrove do të veprojë në bazë të një rregulloreje të veçantë, të përpiluar nga Akademia e ASH-së

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

- Neni 293.* Në rast të mosdorëzimit të vulave dhe dokumenteve përkatëse të Partisë nga përbërja e kaluar, si dhe në rast të pengesave juridike në lidhje me drejtimin e Partisë, Kongresi i Partisë i jep autorizime fuqiplote Kuvendit të Partisë për hapat e mëtejshme.
- Neni 294.* Në rast të pengesave të përmendura në nenin 292, Kuvendi i Partisë obligohet që në afat sa më të shkurtër kohor, të kryejë regjistrimin e subjektit të ri, duke ruajtur trashëgiminë politike dhe historike të Aleancës për Shqiptarët, po ashtu në të njëjtën kohë t'i kryejë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore që lidhen me emrin, stemën dhe flamurin e subjektit të ri, të përcaktuara në nenet 3, 4 dhe 6 të këtij Statuti.
- Neni 295.* Ky statut hyn në fuqi në ditën e sjelljes, ndërsa teksti i konsoliduar me plotësim-ndryshimet deponohet në Gjykatë.